



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 748/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Leonard Gremshi	Zv/Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar
Odise Moçka	Anëtar

Në mbledhjen e datës 22.11.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit me Nr.REF-30293-10-18-2017 me objekt: “*Sherbimi i pastrimit ne Bashkine Mat*”, me fond limit 73.385.319 lekë pa TVSH, parashikuar per t’u zhvilluar ne daten 13.11.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat.”

Ankimues: “Ruçi” sh.p.k
Lagja “Partizani”,
Burrel

Autoriteti kontraktor: Bashkia Mat,
Sheshi “Ahmet Zogu”
Burrel

Baza Ligjore: *Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar;*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorët e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 20.10.2017 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit me Nr.REF-30293-10-18-2017 me objekt: “*Sherbimi i pastrimit ne Bashkine Mat*”, me fond limit 73.385.319 lekë pa TVSH, parashikuar për t’u zhvilluar në datën 13.11.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat.

II.2. Në datën 25.10.2017 operatori ekonomik “Ruçi” sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor. Në ankesë ngrihen pretendime lidhur me hartimin e dokumentave të tenderit të mësipërm.

II.3. Në datën 31.10.2017, nëpërmjet shkresës nr. 566 prot., datë 30.10.2017 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit, duke e pranuar pjesërisht ankesën.

II.4. Në datën 03.11.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar pretendimet si vijon:

I. Në pikën 2.2 Kapaciteti teknik të shtojcës 7 është kërkuar:

“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin teknik të shërbimit të pastrimit për Bashkinë Mat, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit, shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Librezë pune (përkatëse)

- b) Diplomë
- c) CV pëkatëse
- d) Kontratë pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).

Vendosja e këtij kriteri nga ana e Bashkisë Mat është tendencioze me qëllim skualifikimin e sa më shumë operatorëve ekonomikë për të marrë pjesë në këtë procedurë prokurimi. Mbështetur në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, Kreu IV, përcaktohet qartë se kur një inxhinier mund të bëhet drejtues teknik, i cili ka si detyrë që të realizojë projektet në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në pune brenda kushteve të kontratës. Personi i cili fiton statusin e Drejtuesit Teknik në një shoqëri, ka tagrin e plotë të realizojë çdo kontratë në fushën për të cilën është diplomuar dhe për të cilin ka funksionin e Drejtuesit Teknik. Nuk mund të përjashtohet nga procedurat e prokurimit publik një operator ekonomik i cili ka drejtues teknik për të realizuar këtë kontratë që prokurohet por nuk plotëson kriterin që ky drejtues nuk ka punuar për 5 vjet në kontratën e shërbimit të pastrimit. Theksojmë edhe njëherë, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 se inxhinieri i cili fiton statusin e Drejtuesit Teknik në profesionin që është diplomuar, ka aftësinë e duhur për të realizuar çdo kontratë publike ose private për profesionin për të cilin është diplomuar.

Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri diskriminues duke hequr përkufizimin “një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit”, bazuar në VKM nr.42, datë 16.01.2008 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 28.

II. Në pikën 2/3 Kapaciteti teknik të shtojcës 7, është kërkuar:

“Operatori ekonomi pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (një) vit, për punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, licencë, CV.
- 1 (një) Inxhinier Mjedis për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 (një) Inxhinier Kimist për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.”

Kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat se stafi teknik i cituar më sipër duhet të jetë i siguruar për një vit në listpagesa nuk është i mbështetur në asnjë nen të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe LPP. Ky kriter nuk stimulon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, kjo në kundërshtim me LPP pasi një operator ekonomik i ka pjesë të stafit teknik personat e cituar më sipër por nuk i ka të siguruar për një periudhë 1 vjecare nuk mund të marrë pjesë në këtë procedurë edhe pse plotëson më së miri kriterin e stafit teknik. Operatorët ekonomikë kualifikohen në bazë të stafit teknik që disponojnë në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit, kjo bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe LPP.

Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke hequr termin që stafi teknik të figurojë në listpagesa për të paktën 1 vit.

III. Në pikën 2/3 Kapaciteti teknik të shtojcës 7 është kërkuar:

“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (një) vit, për punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, licencë, CV.*
- 1 (një) Inxhinier Mjedis për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.*
- 1 (një) Inxhinier Kimist për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.”*

Autoriteti kontraktor ka kërkuar që inxhinieri i mjedisit të jetë i pajisur me certifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Bazuar në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) nënkupton:

“Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.

Ne nenin 4, pika 4 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” citohet: “Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Ky kriter i vendosur nga ana e autoritetit kontraktor është i ekzagjeruar pasi nuk është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin që prokurohet, bazuar në nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Bazuar në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, vlerësimi i ndikimit në mjedis realizohet në fazën e projektimit të një projekti dhe jo në fazën e zbatimit. Operatorët ekonomikë për procedurën e prokurimit proces ankimi nuk do të realizojnë projektin e kësaj procedure por do të zbatojnë këtë projekt sipas dispozitave të përcaktuara në projekt.

Mbështetur argumentimeve në ligjin e cituar më sipër, kriteri se inxhinieri i mjedisit duhet të jetë i pajisur me certifikatën VNM është kriter i ekzagjeruar.

Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri mbështetur në nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, duke hequr certifikatën e vlerësimit të ndikimit në mjedis.

IV. Në pikën 2/3 Kapaciteti teknik të shtojcës 7 është kërkuar:

“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (një) vit, për punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, licencë, CV.*
- 1 (një) Inxhinier Mjedis për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.*

- 1 (një) Inxhinier Kimist për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.”

Kërkesa e autoritetit kontraktor Bashkia Mat që operatori ekonomik duhet të ketë të siguruar inxhinier kimist është një kriter i ekzagjeruar dhe diskriminues. Duke u bazuar zërave të preventivit dhe kategorive të licensës që kërkohen për procedurën proces ankimi, inxhinieri kimist nuk realizon asnjë zë pune. Qëllimi i kësaj kontrate është largimi i mbetjeve urbane dhe depozitimi i tyre në vendin e caktuar, lagjen e rrugëve dhe edukimin e njerëzve nëpërmjet spoteve publicitare. Duke cituar zërat e preventivit theksojmë se inxhinieri kimist nuk kryen asnjë funksion në realizimin e plotë të kësaj kontrate.

Vendosja si kriter që inxhinieri kimist duhet patjetër të jetë edhe i siguruar, lë për të nënkuptuar se ky kriter është vendosur për të penguar sa më shumë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë.

Kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

V. Në pikën 2/4 Kapaciteti Teknik të shtojcës 7 është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në list pagesat e shoqërisë për të paktën 1 vit. Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumentave:

Kontratë pune e vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, Librezë pune, Diplomën përkatëse. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm.”

Vendosja e kriterit profesional mjek i përgjithshëm i cili të figurojë në listpagesat e shoqërisë për një vit bie ndesh me VK nr. 692, datë 13.12.2001 “Për masat e vecanta të sistemit të shëndetit në punë”, i ndryshuar. Në referim të dispozitave të sipërpërmendura njësia nuk mund të diktojë për mjekun e ndërmarrjes mënyrën e punësimit të tij. Kjo do të jetë në referim të VKM –së së sipërpërmendur dhe në varësi të numrit të punonjësve që ka subjekti. Punësimi i tij pranë subjektit për një periudhë 12 muaj përpara hapjes së procedurave është diskriminuese dhe ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke parapërcaktuar operatorin ekonomik fitues.

Është detyrë e njësisë së prokurimit të shprehet qartë si dhe të kërkojë kritere ligjore dhe jo diskriminuese në mënyrë që operatorët ekonomikë eventualë të përgatisin ofertë të sakta dhe konform detyrimeve ligjore si dhe të garantohet krahasueshmëria ligjore e ofertave.

Kërkojmë heqjen e këtij kriteri diskriminues.

VI. Në pikën 2/6/7/8/9/10 Kapaciteti teknik të shtojcës 7 është kërkuar:

6. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 9001 – 2008** për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
7. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 14001 – 2004** për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
8. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **BS OHSAS 18001 – 2007**, për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

9. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO 50001-2012** për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).
10. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë **ISO3834-2;2005** për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Shënim: Certifikatat e mesiperme (pikat 6,7,8,9dhe 10) duhet të jenë të lëshuara nga Institucione ndërkombëtare të certifikuara/akredituara.

Mbështetur ne nenin 28 “Kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ku citohet që kriteret për kualifikim duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, ISO 9001-2008, ISO 50001-2012, ISO 3834-2:2005 nuk kanë asnjë lidhje me objektin që prokurohet.

Kërkojmë modifikim e këtij kriteri duke i hequr këto ISO.

VII. Në pikën 2/13 Kapaciteti teknik të shtojcës 7 është kërkuar:

Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- a. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (nje) copë;**
- b. Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak **2 (dy) copë;**
- c. Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një)copë.**
- d. Makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 1.5 - 3 ton. Viti i prodhimit jo më poshtë se 1998. Jo më pak se **3 (tre) copë;**
- e. Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m3, te pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë;**
- f. Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 8500 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998 jo më pak se **1 (një) copë;**
- g. Fadromë me goma me kapacitet të kovës prej 1 m3, jo më pak se **1 (një) copë.**

Përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor Bashkia Mat i vitit të prodhimit të makinerive është një kriter diskriminues dhe është në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP-së. Makineritë kolaudohen nga kompania “SGS Albania” e cila përcakton nëse makina plotëson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave të motorit në ajër etj.,) sipas legjislacionit në fuqi për të qarkulluar në rrugët e Republikës së Shqipërisë. Kur makineritë kolaudohen në bazë të rregullave të përcaktuara në Manualin e Kontrollit të Mjeteve nga shoqëria “SCS Albania” atëherë këto makineri mund të përdoren në Republikën e

Shqipërisë. Vendosja e vitit të prodhimit nga autoriteti kontraktor si kusht skualifikimi është një kriter diskriminues, i pabazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe LPP. Kërkojmë heqjen e këtij kriteri.

Theksojme se autoriteti kontraktor, pasi i është përgjigjur ankesës së bërë nga ana jonë për procedurën proces ankimi, ka hequr nga pezullimi procedurën, duke mospritur afatin 10 ditor, afat i cili lejon ankimuesin ti drejtohet Komisionit të Prokurimit Publik.

II.5. Në datën 13.11.2017 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1647/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 2809/1 prot., datë 09.11.2017, bashkëngjitur dokumentacioni mbi trajtimin e ankesës.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese si dhe dokumentave e informacionit të dërguar nga autoriteti kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “[...] Personi i cili fiton statusin e Drejtuesit Teknik në një shoqëri, ka tagrin e plotë të realizojë çdo kontratë në fushën për të cilën është diplomuar dhe për të cilin ka funksionin e Drejtuesit Teknik. Nuk mund të përjashtohet nga procedurat e prokurimit publik një operator ekonomik i cili ka drejtues teknik për të realizuar këtë kontratë që prokurohet por nuk plotëson kriterin që ky drejtues nuk ka punuar për 5 vjet në kontratën e shërbimit të pastrimit. Theksojmë edhe njëherë, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 se inxhinieri i cili fiton statusin e Drejtuesit Teknik në profesionin që është diplomuar, ka aftësinë e duhur për të realizuar cdo kontratë publike ose private për profesionin për të cilin është diplomuar. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri diskriminues duke hequr përkufizimin “një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit”, bazuar në VKM nr.42, datë 16.01.2008 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014, neni 28”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 2, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

“Kandidati ofertues duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë (nga Administratori i shoqërisë) Drejtuesin Teknik të shërbimit të pastrimit për Bashkinë MAT, i cili duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit shoqëruar me dokumentacionin e mëposhtme:

- a) Librezë pune (përkatëse)*
- b) Diplomë*
- c) CV përkatëse*
- d) Kontrate pune midis tij dhe operatorit ekonomik (e vlefshme).”*

III.1.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.1.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2, përcaktohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Neni 28 “Kontratat e Shërbimeve” të VKM nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” parashikon shprehimisht se:

5. Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

III.1.4. Nëpërmjet shkresës nr. 566 prot., datë 30.10.2017, lidhur me këtë pretendim, autoriteti kontraktor ka sqaruar si vijon:

“Në lidhje me këtë konstatim Komisioni vendosi që mos ta pranojë ankesën pasi në VKM nr.42, datë 16.01.2008 përkatësisht në kreun IV “Drejtuesi Teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë”, Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen 5) dhe me përvojë jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi.”

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për

kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Komisioni gjykon se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosuara nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në këtë kuptim kërkesa e autoritetit kontraktor që Drejtuesi Teknik i shoqërisë duhet të ketë një eksperiencë pune jo më pak se 5 vjet në fushën e ofrimit të shërbimit është një kërkesë e ekzagjeruar dhe që shmang pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit. Argumenti i dhënë nga autoriteti kontraktor se “*Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen 5) dhe me përvojë jo më pak se 5 vjet nga diplomimi*” nuk justifikon periudhën e kërkuar si eksperiencë në shërbimet e pastrimit. Kjo e drejtë (drejtues teknik) fitohet pasi personi e ka përvojën në punë për periudhën e përcaktuar në VKM-në nr.42, datë 16.1.2008 “*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*”, Kreu IV “*Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajueshmëria me këtë detyrë*”, pika 1, ku parashikohet shprehimisht:

“Drejtuesi teknik i shoqërisë

a) Drejtuesi teknik i shoqërisë është personi me arsimin universitar përkatës (përcaktuar në lidhjen nr.5) dhe me përvojë pune jo më pak se 5 vjet nga diplomimi. Për personat që kanë mbaruar universitetin me mesatare note nga 9.0 e lart ose ekuivalent (për studime të përfunduara në shtete të huaja) afati të jetë jo më pak se 3 vjet nga diplomimi.

b) Licenca profesionale e shoqërisë kategorizohet mbështetur në diplomimin dhe përvojën personale të drejtuesit/drejtuesve teknikë, kërkesave të tjera që caktohen në këtë rregullore dhe vlerësimit të komisionit për dokumentacionin e paraqitur.

c) Marrëdhëniet e drejtuesit teknik me shoqërinë rregullohen sipas kontratës individuale të punës.”

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës publike objekt prokurimi. Në rastin konkret, referuar specifikimeve teknike si dhe termave të referencës të dokumentave të tenderit, kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me vitet e eksperiencës së drejtuesit teknik në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit i tejkalon përmasat e kontratës që do të prokurohet, ndaj dhe autoriteti kontraktor duhet të bëjë modifikimin e kriterit të mësipërm, duke hequr përcaktimin “*në fushën e ofrimit të shërbimit të pastrimit*”, duke lënë kërkesën për eksperiencë 5 vjecare të Drejtuesit teknik.

Përsa më sipër, pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Ruçi” sh.p.k se: “*Në pikën 2/3 Kapaciteti teknik të shtojcës 7, është kërkuar: “Operatori ekonomi pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (një) vit, për punonjësit si më poshtë:*

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, licencë, CV.
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 (një) Inxhinier Kimist për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.

Kriteri i vendosur nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat se staf i teknik i cituar më sipër duhet të jetë i siguar për një vit në listpagesa nuk është i mbështetur në asnjë nen të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe LPP. Ky kriter nuk stimulon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë, kjo në kundërshtim me LPP pasi një operator ekonomik i ka pjesë të stafit teknik personat e cituar më sipër por nuk i ka të siguar për një periudhë 1 vjecare nuk mund të marrë pjesë në këtë procedurë edhe pse plotëson më së miri kriterin e stafit teknik. Operatorët ekonomikë kualifikohen në bazë të stafit teknik që disponojnë në kohën e zhvillimit të procedurës së prokurimit, kjo bazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe LPP. Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri duke hequr termin që staf i teknik të figurojë në listpagesa për të paktën 1 vit”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 3, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (nje) vit, për punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, Licencë, CV.
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, dhe Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis
- 1 (një) Inxhinier Kimist, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.”

III.2.2. Në shtojcën 12 “Termet e referencës” të dokumentave të tenderit, është parashikuar: “Objekti dhe qellimi i shërbimit: Bashkia Mat, ne saje edhe te Reformes Administrative – Territoriale, perbehet nga 8 (tete) Njesi Administrative, perkatesisht Njesia Administrative: Burrel; Lis, Rukaj, Derjan, Macukull, Koms, Baz, Ulez.

Objekti dhe qellimi i këtij shërbimi është që të kryhet një shërbim pastrimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane, me një efikasitet sa më të lartë, me cilësi të lartë dhe për popullsinë dhe sipërfaqen brenda territorit të Bashkisë Mat, brenda kuadrit ligjor.

Sipas të dhënave të përgjithshme për Bashkinë Mat: Shërbimi i pastrimit dhe i trajtimit të mbetjeve do të kryhet sipas tabelës së mëposhtme.

Nr	Emri i Zones se Sherbimit	Zona e Sherbimit	Popullsia e Sherbyer ne secilen zone	% e popullsise qe nuk ju kryhet ky sherbim	Popullsia ekstra(turiste) mesatare ditore	Gjenerimi i mbetjeve kg/banore/dite	Rrugjet (distance nga landfilli njeri krah) km
1	Nj.Adm.Burrel	Urbane	17,190	20%	0	0.6	3
2	Nj.Adm Ulez+Baz	Semi Urban	4,900	50%	0	0.4	30
3	Nj.Adm Komsj	Rurale	5000	70%	0	0.3	10
4	Nj.Adm. Rukaj +Lis	Rurale	8013	60%	0	0.3	27
	Totali		35,103				

Sherbimi i pastrimit konsiston ne kryerjen e zerave te punes dhe volumet e punimeve sipas tabelës se meposhteme.

Operatorët ekonomike pjesëmarrës ne kete procedure prokurimi duhet te perllorisin numrin e trajtimeve si dhe ofertat e tyre per periudhen nga data **05.10.2017** deri me **31.12.2021**, ofertat duhet te jepen per te gjith totalin e perudhes, sipas **preventivit me poshte :**

Nr	Emertimi i sherbimit qe kryhet	Njesia	Sasia	Çmimi/nje si ne dite	Nr. i trajtimeve	Vlera leke
1	Fshirje me fshese rruge,trotuare,sheshe, naten	m ² /dite	52692		1548	
2	Fshirje me mjet teknologjik rruge e sheshe pa parkimet	m ² /dite	68316		1548	
3	Lagia e rrugeve dhe shesheve me autobot 2 her ne dite	m ² dite	56511		763	
4	Grumbullim, transport,depozitim, trajtim i mbetjeve Nj.Adm Burrel	ton/dite	8.2512		1548	
5	Grumbullim, transport,depozitim, trajtim i mbetjeve Nj.Adm Ulez+Baz	ton/dite	0.98		1548	
6	Grumbullim, transport,depozitim, trajtim i mbetjeve Nj.Adm Komsj	ton/dite	0.45		1548	
7	Grumbullim, transport,depozitim, trajtim i mbetjeve Nj.Adm Rukaj+Lis	ton/dite	0.96156		1548	
8	Edukim public sipas VKB	Leke		100 000	5	
	Shuma					
	Tvsh 20%					
	Totali					

Per Njesine Administrative Ulez-Baz; Njesine Administrative Komsi dhe Njesine Administrative Rukaj-Lis grumbullim, transport,depozitim, trajtim i mbetjeve do te kryhet sipas grafikut ne DST, 2 her ne jave.

Numri i trajtimeve nenkupton numrin total te kryerjes se sherbimeve perkatese.

Lagia e rrugeve dhe shesheve me autobot do te behet 2 here ne dite sipas periudhes se percaktuar ne DST, sipërfaqja per nje here eshte 56511 m² ,prandaj numri i trajtimeve eshte llogoritur per 2 here ne dite .

Sherbim: heqja e mbeturinave nga pika e grumbullimit - kontenjeret metalik modeli 1.1 m³ me mjet teknologjik .

Per Njesine Administrative Burrel: *sherbimi i terheqjes dhe depozitimit do te kryhet sipas frekuences : 7 (shtate) dite ne jave nga ora 22:00 deri ne 06:00.*

Dorezimi i mbeturinave do te behet ne konteniere 1.1 m³ , nevoiten 71(shtatedhjete e nje) konteniere sipas analizes se kosos, keto konteniere do te sigurohen nga ana e bashkise ndersa ruajtja; mirembajtja e konteniereve do te sigurohen nga Operatori i Sherbimit.

Grumbullimi dhe terheqja do te behet me mjet teknologjik 10 ton.

Per Njesine Administrative Ulez+Baz: *Sherbimi i terheqjes dhe depozitimit do te kryhet sipas frekuences: 2 here/jave, gjate dites, dita percaktohet sipas tabelës se intinerarit.*

Dorezimi i mbeturinave do te behet ne konteniere 1.1 m³ , nevoiten 29 (njezet e nente) konteniere sipas analizes se kosos, keto konteniere do te sigurohen nga ana e Bashkise ndersa ruajtja; mirembajtja e konteniereve do te sigurohen nga Operatori i Sherbimit.

Grumbulloimi dhe terheqja do te behet me mjet teknologjik 5 ton.

Intinerari i kryerjes se sherbimit: nga pika me e larget (tuneli i Shkopetit) –Qyteza Ulez dhe zona pergjate aksit nacional Ulez-Baz-Burrel deri ne vend depozitim.

Per Njesine Administrative Komsi: *Sherbimi i terheqjes dhe depozitimit do te kryhet sipas frekuences: 2 here/jave, gjate dites, dita percaktohet sipas tabelës se intinerarit.*

Dorezimi i mbeturinave do te behet ne konteniere 1.1 m³ , nevoiten 13 (trembedhjete) konteniere sipas analizes se kosos, keto konteniere do te sigurohen nga ana e Bashkise ndersa ruajtja; mirembajtja e konteniereve do te sigurohen nga Operatori i Sherbimit.

Grumbulloimi dhe terheqja do te behet me mjet teknologjik 5 ton.

Intinerari i kryerjes se sherbimit: nga pika me e larget (Lagjia tek Uzina) deri tek vend depozitimi.

Per Njesine Administrative Rukaj+Lis: *Sherbimi i terheqjes dhe depozitimit do te kryhet sipas frekuences: 2 here/jave, gjate dites, dita percaktohet sipas tabelës se intinerarit.*

Dorezimi i mbeturinave do te behet ne konteniere 1.1 m³ , nevoiten 29 (Njezet e nente) konteniere sipas analizes se kosos, keto konteniere do te sigurohen nga ana e Bashkise ndersa ruajtja; mirembajtja e konteniereve do te sigurohen nga Operatori i Sherbimit.

Grumbulloimi dhe terheqja do te behet me mjet teknologjik 5 ton.

Intinerari i kryerjes se sherbimit: Nga Fshati Uraka pergjate rruges nacionale deri ne Njesine Administrative Lis, pastaj nga Lapidari ne SukBuall deri tek Ura e Luses sipas aksit nacional, dhe kthimi nga Ura e Luses tek Ura e Matit-Burrel deri ne vend depozitim.”

III.2.3 Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që

autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.2.4. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

Ndërsa në pikën 5, po këtu, prashikohet shprehimisht:

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.2.5. Komisioni gjykon se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.2.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës publike objekt prokurimi. Në rastin konkret, KPP konstaton se, referuar specifikimeve teknike si më sipër cituar, kërkesa e autoritetit kontraktor përta i përket figurimit në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (nje) vit e stafit teknik, kjo kërkesë është vendosur për të krijuar një panoramë të përgjithshme lidhur me kapacitetet profesionale që

disponojnë operatorët ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të kërkuar duhet të vërtetojnë se zotërojnë personelin e nevojshëm, në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet nga operatori ekonomik, që ky i fundit disponon stafin teknik, duke treguar kapacitetet e këtij të fundit në lidhje me personelin, por jo detyrimisht që në listpagesat në fjalë të figurojnë të njëjtat emra që lidhen me këto pozicione gjatë gjithë periudhës të përcaktuar më sipër; pasi në stafin e operatorëve ekonomikë mund të ketë lëvizje të punonjësve.

Pra periudha e kërkuar në listpagesa nuk është kërkesë e ekzagjeruar pasi i shërben qëllimit të autoritetit kontraktor për perftimin e ofertës më të mirë dhe më të leverdisshme për kryerjen e shërbimit të kërkuar në dokumentat e procedurës së prokurimit, por AK duhet të lejojë dhe të përcaktojë edhe alternativa të tjera për përmbushjen e kapacitetit lidhur me personelin kryesor të nevojshëm për të zbatuar kontratën sic janë lista e personelit kryesor, kontratat e punës, CV-të, dëshmitë e kualifikimit etj., duke marrë parasysh që punonjësit mund të jenë kontraktuar për këtë periudhë për kryerjen e shërbimeve. Është në të drejtën e autoritetit kontraktues të përcaktojë kriteret për kualifikim, gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin në fuqi duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik.

Sqarojmë se kjo procedurë konkurruese është një kontratë shumëvjeçare, e cila ka një volum shërbimesh të konsiderueshëm ndaj dhe autoriteti kontraktues i cili është organi përgjegjës për menaxhimin dhe mirëpërdorimin e fondeve publike, e ka në përgjegjësinë e tij përcaktimin dhe vendosjen e kriterëve dhe kërkesave të duhura, në përputhje dhe proporcion me objektin dhe natyrën e kontratës që prokurohet.

Pretendimi i ankimuesit qëndron pjesërisht.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Ruçi” sh.p.k se: *“Në pikën 2/3 Kapaciteti teknik të shtojcës 7 është kërkuar: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (një) vit, për punonjësit si më poshtë:*

- *1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, licencë, CV.*
- *1 (një) Inxhinier Mjedis për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.*
- *1 (një) Inxhinier Kimist për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.*

Autoriteti kontraktor ka kërkuar që inxhinieri i mjedisit të jetë i pajisur me certifikatën për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis. Bazuar në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) nënkupton:

“Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis (VNM) është procesi që kryhet për vlerësimin e përgjithshëm të ndikimeve të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, nga projekte të propozuara publike dhe private.

Ne nenin 4, pika 4 të ligjit nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” citohet: “Vlerësimi i projektit përfshin, gjithashtu, propozimin e masave të nevojshme për parandalimin, reduktimin, zbutjen, minimizimin e ndikimeve të tilla ose rritjen e ndikimeve pozitive mbi mjedisin, gjatë zbatimit të projektit, përfshirë edhe vlerësimin e efekteve të pritshme të masave të propozuara.

Ky kriter i vendosur nga ana e autoritetit kontraktor është i ekzagjeruar pasi nuk është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin që prokurohet, bazuar në nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014.

Bazuar në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, vlerësimi i ndikimit në mjedis realizohet në fazën e projektimit të një projekti dhe jo në fazën e zbatimit. Operatorët ekonomikë për procedurën e prokurimit proces ankimi nuk do të realizojnë projektin e kësaj procedure por do të zbatojnë këtë projekt sipas dispozitave të përcaktuara në projekt. Mbështetur argumentimeve në ligjin e cituar më sipër, kriteri se inxhinieri i mjedisit duhet të jetë i pajisur me certifikatën VNM është kriter i ekzagjeruar.

Kërkojmë modifikimin e këtij kriteri mbështetur në nenin 28 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, duke hequr certifikatën e vlerësimit të ndikimit në mjedis,” Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 3, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (nje) vit, për punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, Licencë, CV.
- 1 (një) Inxhinier Mjedis, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, dhe Certifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 (një) Inxhinier Kimist, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.”

III.3.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.3.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2, përcaktohet se: “Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën

dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”

III.3.4. Në ligjin nr.10440, datë 7.7.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, neni 2, “Objekti”, dhe nënin 3 “Fusha e zbatimit” është përcaktuar:

“Objekti i këtij ligji është përcaktimi i kërkesave, përgjegjësi, rregullave dhe procedurave për vlerësimin e ndikimeve të rëndësishme negative në mjedisin e Republikës së Shqipërisë, të projekteve të propozuara, private apo publike.”

“Ky ligj zbatohet për projektet e propozuar, private apo publike, të cilat mund të shkaktojnë ndikime të rëndësishme negative, të drejtpërdrejta ose jo, në mjedis, si pasojë e madhësisë, natyrës apo vendimmarrjes së tyre.”

Në nenin 8 e ligjit nr.10440 datë 7.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, i ndryshuar, parashikohet se “Neni 8

Projektet që i nënshtrohen vlerësimin paraprak të VNM-së

Projektet që i nënshtrohen vlerësimin paraprak të ndikimit në mjedis janë:

a) projektet e listuara në shtojcën II, bashkëlidhur;

b) çdo ndryshim a shtesë në projektet e listuara në shtojcën I apo II, të licencuara paraprakisht, që mund të shkaktojë efekte të rëndësishme negative mbi mjedisin;

c) projektet e listuara në shtojcën I, që ndërmerren, ekskluzivisht apo kryesisht, për testimin dhe zhvillimin e metodave ose produkteve të reja, të cilat nuk janë përdorur për më shumë sedy vjet;

ç) projektet e listuara apo jo në shtojcën I ose II, që nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë apo nuk janë të nevojshme për administrimin e zonave veçanërisht të mbrojtura, por që, veçmas apo në bashkëveprim me plane dhe projekte të tjera, mund të shkaktojnë efekte negative të rëndësishme në këto zona. Në këtë rast, raporti paraprak i VNM-së përfshin edhe vlerësimin e ndikimeve të këtyre projekteve në atë zonë, duke marrë parasysh objektivat e ruajtjes dhe mbrojtjes së vendit ku do të zbatohet projekt”

III.3.5. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.

Komisioni gjykon se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes, mbi modifikimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, për procedurën e prokurimit objekt ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është me vend të ndalet në një test balancues të dy elementëve kryesorë. Së pari, nëse kërkesa në fjalë është e përshtatshme për arritjen e synimit të kërkuar dhe së dyti, nëse kërkesa në fjalë shkon përtej asaj, se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin. Gjithashtu, në shqyrtimin e kriterit të mësipërm të kualifikimit, K.P.P. gjykon të ndalet edhe në faktin nëse kriteri i mësipërm

është në proporcion me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet në zbatim të nenit 46 pika 1 të LPP-së.

III.3.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se synimi parësor i autoritetit kontraktor është vërtetimi se ofertuesi disponon staf të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës publike objekt prokurimi. Në rastin konkret, KPP konstaton se, referuar specifikimeve teknike dhe termave të referencës, kërkesa e autoritetit kontraktor që *Inxhinieri Mjedisi duhet të disponojë Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis* i tejkalon përmasat e kontratës që do të prokurohet, bazuar në objektin e prokurimit dhe në ligjin nr. 10440, datë 7.7.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis” si më sipër cituar.

Pretendimi i ankimesit qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Ruçi” sh.p.k se: “Në pikën 2/3 Kapaciteti teknik të shtojcës 7 është kërkuar: “Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (një) vit, për punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, licencë, CV.
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV dhe Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.
- 1 (një) Inxhinier Kimist për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.

Kërkesa e autoritetit kontraktor Bashkia Mat që operatori ekonomik duhet të ketë të siguruar inxhinier kimist është një kriter i ekzagjeruar dhe diskriminues. Duke u bazuar zërave të preventivit dhe kategorive të licensës që kërkohen për procedurën proces ankimi, inxhinieri kimist nuk realizon asnjë zë pune. Qëllimi i kësaj kontrate është largimi i mbetjeve urbane dhe depozitimi i tyre në vendin e caktuar, lagjen e rrugëve dhe edukimin e njerëzve nëpërmjet spoteve publicitare. Duke cituar zërat e preventivit theksojmë se inxhinieri kimist nuk kryen asnjë funksion në realizimin e plotë të kësaj kontrate. Vendosja si kriter që inxhinieri kimist duhet patjetër të jetë edhe i siguruar, lë për të nënkuptuar se ky kriter është vendosur për të penguar sa më shumë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë prandaj kërkohet heqjen e këtij kriteri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti Teknik”, pika 3, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

“Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar staf teknik i cili duhet të figurojë në listpagesat e shoqërisë për të paktën 1 (një) vit, për punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) Inxhinier Mekanik, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, Licencë, CV.
- 1 (një) Inxhinier Mjedisi, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV, dhe Çertifikatë nga Ministria e Mjedisit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis.

- *1 (një) Inxhinier Kimist, për të cilin duhet të paraqitet kontratë pune e vlefshme, diplomë, CV.*

III.4.2. Në nenin 46, pika 1, gërma “b” të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.*

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

III.4.3. Në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, neni 28 “Kontratat e shërbimeve”, pika 2, përcaktohet se: *“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.”*

Ndërsa në pikën 5, po këtu, prashikohet shprehimisht:

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:

a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose

b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose

c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose

ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.”

III.4.4. Komisioni gjykon se fryma dhe qëllimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, e në funksion të kësaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimes, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se kërkesa në fjalë i tejkalon përmasat e kontrates që prokurohet. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë inxhinier kimist si alternative e inxhinierit të mjedisit, duke nxitur pjesëmarrjen në tender të shoqërive që e plotësojnë këtë kërkesë me njërin prej mundësive (inxhinier mjedisi/inxhinier kimist). Akoma më tej, KPP gjykon se, me qëllim nxitjen e konkurrencës dhe mos kufizimin e pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit publik, për sa kohë që autoriteti kontraktor ka parashikuar kërkesën e mësipërme në lidhje me formimin arsimor/universitar të inxhinierit të kërkuar, si një kërkesë në terma funksionale (referuar natyrës së shërbimit të kërkuar), atëherë KPP gjykon se në rastin konkret duhet aplikuar edhe termi “ekuivalent” me anë të

së cilës operatorët ekonomikë mund të dëshmojnë se disponojnë në stafin e tyre inxhinier të cilët kanë kompetencat dhe njohuritë e inxhinierit kimist/mjedisi ose ekuivalent me këto, në funksion të realizimit të synimit dhe kontratës objekt prokurimi.

Pretendimi i ankimesit qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes "Ruçi" sh.p.k se: "Në pikën 2/4 Kapaciteti Teknik të shtojcës 7 është kërkuar: "Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar një mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në list pagesat e shoqërisë për të paktën 1 vit. Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumentave: Kontratë pune e vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, Librezë pune, Diplomën përkatëse. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm." Vendosja e kriterit profesional mjek i përgjithshëm i cili të figurojë në listpagesat e shoqërisë për një vit bie ndesh me VK nr. 692, datë 13.12.2001 "Për masat e vecanta të sistemit të shëndetit në punë", i ndryshuar. Në referim të dispozitave të sipërpërmendura njëzia nuk mund të diktojë për mjekun e ndërmarrjes mënyrën e punësimit të tij. Kjo do të jetë në referim të VKM –së së sipërpërmendur dhe në varësi të numrit të punonjësve që ka subjekti. Punësimi i tij pranë subjektit për një periudhë 12 muaj përpara hapjes së procedurave është diskriminuese dhe ul konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke parapërcaktuar operatorin ekonomik fitues. Është detyrë e njësisë së prokurimit të shprehet qartë si dhe të kërkojë kriterë ligjore dhe jo diskriminuese në mënyrë që operatorët ekonomikë eventualë të përgatisin ofertë të sakta dhe konform detyrimeve ligjore si dhe të garantohet krahasueshmëria ligjore e ofertave. Kërkojmë heqjen e këtij kriteri diskriminues", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 7 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 4, rezulton se është parashikuar nga ana e autoritetit kontraktor, plotësimi i kërkesës së mëposhtme:

"Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm dhe duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 1 (vite). Kjo duhet të vërtetohet me paraqitjen e dokumenteve: Kontratë Pune e vlefshme, Urdhër Mjeku, CV, Librezë Pune, Diplomën përkatëse. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit duhet të ketë të punësuar 1 (një) mjek të përgjithshëm i cili duhet të rezultojë në list-pagesat e shoqërisë dhe ta vërtetojë me dokumentacionin e mësipërm."

III.5.2. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: "Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e

nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.5.3. Në Vendimin Nr.108, datë 9.2.2011 “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”,

Kapitulli II “Klasifikimi i punëdhënësve në grupe, për efekt të organizimit të punëmarrësve në shërbimet për mbrojtjen dhe parandalimin”, përcaktohet se:

“1. Për efekt të organizimit të shërbimit të brendshëm për mbrojtjen dhe parandalimin, punëdhënësit janë klasifikuar në katër grupe, si më poshtë vijon:

1.1 Grupi A përfshin punëdhënësit me më shumë se 1000 (një mijë) punëmarrës. Ky numër punëmarrësish reduktohet në:

1.1.1 500 (pesëqind) punëmarrës për ndërmarrjet e:

a) industrisë së pastrimit dhe shpërndarjes së ujit;

b) industrisë së transformimit të metaleve, mekanikës e precizionit dhe industrisë optike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industrinë e referuara në nënndarjen

1.1.2, shkronjat “dh”, “e”, “ë” e “f”;

c) industrinë e tjera prodhuese, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtari në industrinë referuara në pikën 1.1.2, shkronja “g”.

1.1.2 250 (dyqind e pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet e:

a) industrisë së prodhimit e të shpërndarjes së energjisë elektrike, gazit, avullit dhe ujit të ngrohtë;

b) industrisë së prodhimit dhe të përpunimit fillestar të metaleve;

c) prodhimit industrial prej guri, çimentos, betonit, qeramikës, qelqit dhe të tjerët;

ç) industrisë kimike, me përjashtim të ndërmarrjeve/institucioneve që ushtrojnë veprimtarinë në industrinë e referuara në 1.1.3, shkronjat “ç”, “d” dhe “dh”;

d) prodhimit industrial të fibrave artificiale dhe sintetike;

dh) industrisë së fabrikimit të veprave në metale;

e) industrisë së ndërtimit të makinerive dhe të pajisjeve mekanike;

ë) industrisë së ndërtimit dhe të autopjesëve;

f) industrisë së ndërtimit të pajisjeve të tjera të transportit;

g) industrisë së drurit dhe mobilieve të drurit;

gj) industrisë së ndërtimit dhe të punëve publike.

1.1.3. 50 (pesëdhjetë) punëmarrës për ndërmarrjet:

a) e industrisë bërthamore;

b) me furrat koks;

c) e përpunimit të naftës;

ç) e industrisë së prodhimit të kimikateve bazë;

d) e industrisë petro-kimike dhe karbokitike;

dh) e industrisë së prodhimit të produkteve të tjera kimike, kryesisht për industri dhe bujqësi.

1.2 Grupi B përfshin punëdhënësit me punëmarrës:

a) nga 251 deri në 1000 persona, të cilët nuk janë përfshirë në grupin A;

b) nga 100 deri në 250 persona, të cilët nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.1 të këtij kreu;

c) nga 50 deri në 200 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.2 të këtij kreu;

ç) nga 20 deri në 50 persona, që nuk janë të përfshirë në sektorët e industrisë së përcaktuar në pikën 1.1.3 të këtij kreu.

1.3 Grupi C përfshin punëdhënësit me më pak se 200 (dyqind) punëmarrës, të cilët nuk përfshihen në grupet A dhe B.

1.4 Grupi D përfshin punëdhënësit që punësojnë më pak se 20 (njëzet) punëmarrës”.

III.5.4. Në Vendimin Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, pika 1, pika 3, gërma” b “ dhe pika 4 gërma “b” është përcaktuar:

1. “Pas pikës 5, të kreut II, shtohet pika 6, me përmbajtje, si më poshtë vijon: “6. Punëdhënësit e grupeve “A” dhe “B”, në zbatim të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, për çdo 700 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës. Ndërsa punëdhënësit e grupeve “C” dhe “D”, për çdo 1500 punëmarrës, sigurojnë shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë.”. [...]

3. Në kreun IV, pika 7 ndryshohet, si më poshtë vijon: “7. Personi përgjegjës, i ngarkuar nga shërbimi i specializuar jashtë ndërmarrjes për menaxhimin e riskut, duhet të plotësojë kriteret e mëposhtme:

b) në lidhje me shëndetin në punë të ketë formim profesional në fushën e mjekësisë së përgjithshme dhe i cili:

b.1 të jetë kualifikuar si mjek i sëmundjeve profesionale/mjek pune;

b.2 të jetë i licencuar nga Urdhri i Mjekut për ushtrimin e profesionit”.

4/b) Pas pikës 2 shtohet pika 3, me këtë përmbajtje:

“3. Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi”.

III.5.5. Në Vendimin Nr. 639, datë 7.9.2016b “Për përcaktimin e rregullave, të procedurave e të llojeve të testeve ekzaminuese mjekësore, që do të kryhen në varësi të punës së punëmarrësit, si dhe të mënyrës së funksionimit të shërbimit mjekësor në punë”, pika 1, gërma “ë”, përcaktohet se:

“Mjeku i punës/sëmundjeve profesionale”, çdo mjek që gëzon të drejtën e ushtrimit të profesionit në Republikën e Shqipërisë, i cili ka një formim afatshkurtër ose afatgjatë në fushën e mjekësisë së punës/sëmundjeve profesionale, të ofruar nga institucionet publike ose private të

licencuara në Republikën e Shqipërisë ose në institucione jashtë vendit të njohura nga strukturat përkatëse në Republikën e Shqipërisë”ë.

III.5.6. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, mbi modifikimin e kriterit për mjekun e ndërmarrjes, për procedurën e prokurimit objekt ankimi; Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se autoriteti kontraktor gjatë hartimit të kriterit të dokumentave të prokurimit objekt ankimi, duhet të ketë parasysh parashikimet e Vendimit Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”; në lidhje me detyrimin e punëdhënësit për të siguruar shërbimin mjekësor në ndërmarrje nëpërmjet mjekut të punës, apo nëpërmjet mjekut të punës të kontraktuar nga jashtë, sipas grupeve përkatëse në të cilin mund të bëjnë pjesë operatorët ekonomikë pjesmarrës, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

III.5.7. Gjithashtu Komisioni gjykon se kërkesa e autoritetit ku mjeku i punës duhet të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 1 vit, është një kërkesë e ekzagjeruar; duke patur parasysh se Vendimi Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin Nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”, i cili ka shfuqizuar Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i Këshillit të Ministrave, “Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë”; ka hyrë në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare (pas datës 21 korrik 2015) dhe i ka shtrirë efektet e zbatimit një vit pas hyrjes në fuqi (21 korrik 2016).

Kërkesa e autoritetit kontraktor në lidhje me periudhën që mjeku i punës duhet të figurojë në listapagesa, duhet të jetë në përputhje përveç sa u përmend më sipër, gjithashtu dhe me natyrën e punësimit të mjekut (kohë e plotë), në referencë të ndarjeve të grupeve përkatëse, si dhe numrit respektiv të punonjësve për secilin grup të përcaktuar më sipër.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “*Në pikën 2/6/7/8/9/10 Kapaciteti teknik të shtojcës 7 është kërkuar:*

- 1. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001 – 2008 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).*
- 2. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 14001 – 2004 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).*
- 3. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë BS OHSAS 18001 – 2007, për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).*
- 4. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 50001-2012 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).*
- 5. Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO3834-2;2005 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).*

Shënim: *Certifikatat e mesiperme (pikat 6,7,8,9dhe 10) duhet të jenë të lëshuara nga Institucione ndërkombëtare të certifikuara/akredituara.*

Mbështetur ne nenin 28 “Kontratat e shërbimeve” të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 ku citohet që kriteret për kualifikim duhet të jenë në përpjestim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, **ISO 9001-2008, ISO 50001-2012, ISO 3834-2:2005 nuk kanë asnjë lidhje me objektin që prokurohet.** Kërkojmë modifikim e këtij kriteri duke i hequr këto ISO”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 6,7,8,9,10 nga ana e autoritetit kontraktor ishte kërkuar:

6. *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001 – 2008 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).*
7. *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 14001 – 2004 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).*
8. *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë BS OHSAS 18001 – 2007, për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).*
9. *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 50001-2012 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).*
10. *Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO3834-2;2005për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).*

Shënim: Certifikatat e mesiperme (pikat 6,7,8,9dhe 10) duhet të jenë të lëshuara nga Institucione ndërkombëtare të certifikuara/akredituara.

III.6.2. Në përgjigje të ankesës së operatorit ekonomik “Ruçi” sh.p.k, autoriteti kontraktor, nëpërmjet një shtojcë të publikuar në SPE, ka bërë modifikimin e kriterëve kualifikuese për certifikatat ISO, si vijon:

1. ISHTE:

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 9001 – 2008 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 14001 – 2004 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë BS OHSAS 18001 – 2007, për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 50001-2012 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO3834-2;2005për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Shënim: Certifikatat e mesiperme (pikat 6,7,8,9dhe 10) duhet të jenë të lëshuara nga Institucione ndërkombëtare të certifikuara/akredituara.

➤ **BEHET:**

Hiqen :

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO 50001-2012 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me certifikatë ISO3834-2;2005 për ushtrim te aktivitetit objekt i prokurimit, (te vlefshme).

Dhe modifikimin si me poshte:

Certifikatat e mesiperme (pikat 6,7,8,) duhet të jenë të lëshuara nga Institucione ndërkombëtare ose kombëtare të certifikuar/akredituara.

III.6.2. Në nenin 46 pika 1 gërma “a” dhe gërma “b” e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

III.6.3. Në nenin 46, pika 2 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “[...] Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit. [...]”.

III.6.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 30 “Kërkesat e cilësisë”, përcaktohet se: “1. Autoriteti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga sistemet e standardizimit kombëtar ose ndërkombëtar. Kjo dispozitë zbatohet edhe kur kërkesat teknike u referohen kualifikimeve të kandidatit ose të ofertuesit.

2. *Certifikatat e kërkuara duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, duke respektuar edhe parimin e mosdiskriminimit”.*

III.6.5. Sipas përgjigjes që autoriteti kontraktor i ka dhënë ankimuesit, nëpërmjet shkresës nr.566 prot., datë 30.10.2017, rezulton se, në lidhje me këtë konstatim Komisioni i Shqyrtimit të Ankesës vendosi që ta pranojë pjesërisht konstatimin pasi ISO 50001-2012, ISO 3834-2:2005 nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

III.6.6. Për sa më sipër cituar Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendimet e ankimuesit përsa i përket certifikatave ISO 50001-2012, ISO 3834-2:2005 janë pranuar nga autoriteti kontraktor, gjë që është pasqyruar edhe në modifikimin e dokumentave të tenderit, ndaj dhe këto pretendime nuk do të merren shqyrtim nga ky Komision.

Përsa i përket pretendimit të ankimuesit për certifikatën ISO 9001 – 2008 Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se është e rëndësishme që operatori ekonomik pjesëmarrës të jetë i pajisur me një certifikatë të tillë për vetë rëndësinë që ajo mbart, pasi dëshmon se sistemi i administrimit të firmës së certifikuar siguron dhënien e një shërbimi cilësor d.m.th që i

përgjigjet asaj që kërkohet nga klienti. Një certifikim i tillë i përket certifikimit të sistemit pasi në këtë rast është kërkuar që operatori ekonomik të jetë i certifikuar për menaxhimin e cilësisë për sistemin e administrimit të shoqërisë.

Certifikata ISO 9001:2008 është një standard ndërkombëtar që lidhet me sistemin e menaxhimit të cilësisë të çdo organizate nga të gjitha llojet e sektorëve dhe aktiviteteve të biznesit, pra lidhet direkt me shoqërinë.

III.6.7. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor ndër të tjera për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të teknike, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, reputacionin dhe besueshmërinë, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma "b", të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, i cili parashikon se: "[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]". Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetin teknik lidhur me certifikatën ISO 9001:2008, në përputhje me objektin e prokurimit dhe volumin e kontratës që do të prokurohet.

Rrjedhimisht pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.7. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik "Ruçi" sh.p.k sipas së cilës: "Në pikën 2/13 Kapaciteti teknik të shtojcës 7 është kërkuar: "Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

- a. *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se 1 (nje) copë;*
- b. *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak 2 (dy) copë;*
- c. *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se 1 (një) copë.*
- d. *Makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 1.5 - 3 ton. Viti i prodhimit jo më poshtë se 1998. Jo më pak se 3 (tre) copë;*
- e. *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe djathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës,*

*mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë**;*

f. *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 8500 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998 jo më pak se **1 (një) copë**;*

g) *Fadromë me goma me kapacitet të kovës prej 1 m³, jo më pak se **1 (një) copë**.*

Përcaktimi nga ana e autoritetit kontraktor Bashkia Mat i vitit të prodhimit të makinerive është një kriter diskriminues dhe është në kundërshtim me nenin 1 dhe 2 të LPP-së. Makineritë kolaudohen nga kompania “SGS Albania” e cila përcakton nëse makina plotëson kriteret (kontrolli teknik, shkarkimin e gazrave të motorit në ajër etj.) sipas legjislacionit në fuqi për të qarkulluar në rrugët e Republikës së Shqipërisë. Kur makineritë kolaudohen në bazë të rregullave të përcaktuara në Manualin e Kontrollit të Mjeteve nga shoqëria “SCS Albania” atëherë këto makineri mund të përdoren në Republikën e Shqipërisë. Vendosja e vitit të prodhimit nga autoriteti kontraktor si kusht skualifikimi është një kriter diskriminues, i pabazuar në VKM nr. 914, datë 29.12.2014 dhe LPP. Kërkojmë heqjen e këtij kriteri”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 13 dhe 14, është kërkuar:

“Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me shkrim mbi disponueshmërinë e mjeteve, ku të përcaktohen të dhënat teknike dhe sasitë përkatëse për mjetet e mëposhtme:

a. *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës 10 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë**;*

b. *Makinë teknologjike transportuese, me ngarkim fundor ose anësor, me kapacitet mbajtës jo më pak se 5 ton, raport kompaktimi 1:4 - 1:6, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak **2 (dy) copë**;*

c. *Makine transportuese të kontenierëve me platformë ngarkimi nga pas, për të mundësuar ngarkimin dhe shkarkimin e kontenierëve pa sjellë dëmtimin e tyre, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë**.*

d. *Makinë vetëshkarkuese e hapur nga sipër, me hapje të spondit anësor ose nga pas, të pajisura me mbulesë, për grumbullimin dhe transportimin e mbetjeve vëllimshme dhe të ndërtimit dhe mirëmbajtje të pikave gjatë ditës, etj; me kapacitet transportues 1.5 - 3 ton. Viti i prodhimit jo më poshtë se 1998. Jo më pak se **3 (tre) copë**;*

e. *Makina teknologjike për fshirjen e rrugëve, me kapacitet mbajtës 4-6 m³, të pajisura me 2 fshesa anësore (majtas dhe dhjathtas) dhe një fshesë qendrore rrul, sistem thithës të pluhurave (aspirator) dhe sistem spërkatje me ujë gjatë punës, mundësisht me tub aspirimi të jashtëm thithës, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998, jo më pak se **1 (një) copë**;*

f. *Makina për larjen e rrugëve, (autobote) të pajisura me pompë për larjen e rrugëve me presion, me dy ose më shumë pjata larëse në pjesën e përparme, me kapacitet mbajtes jo më pak se 8500 litra ujë, i vitit të prodhimit jo më poshtë se 1998 jo më pak se **1 (një) copë**;*

g. Fadromë me goma me kapacitet të kovës prej 1 m³, jo më pak se **1 (një) copë**.
Për Mjetet teknologjike të kërkuara në pikën 11, gërma a – g, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

- a) Mjetet në pronësi duhet të shoqërohen me akt pronësie original ose kopje të noterizuar (kontrata shit-blerje ose kontrata dhurimi).
- b) Mjetet me qira duhet të shoqërohen me kontratë qiraje si dhe me aktin e pronësisë së qiradhënësit (original ose kopje e noterizuar). Kontrata e qerasë duhet të përmbajë objektin dhe afatin e marrjes me qera të mjeteve (e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi).
- c) Për mjetet që shënohen në regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin si: - leje qarkullimi; - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- d) Per mjetet me qira, duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e tij: - certifikatën e kontrollit teknik; - siguracionin e mjetit; - kontratën përkatëse të qerasë/furnizimit, e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi. Ky dokumentacion duhet të jetë i vlefshëm.
- e) Operatori ekonomik duhet të paraqesë foto për secilin mjet të deklaruar në pronësi ose me qira, ku të jetë e dukshme dhe targa e mjetit.”

III.7.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.
b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, 6 kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;”

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”

III.7.3. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, parashikon shprehimisht se :

“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën”.

III.7.4. Referuar Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 1, pika 2 përcaktohet:

c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;

ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;

III.7.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se bindja e autoritetit kontraktor që operatorët ekonomikë pjesmarrës disponojnë kapacitetet e duhura teknike në lidhje me mjetet e transportit vërtetohet me anë të dokumentacionit përkatës të përcaktuar nga Ligji Nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar; me anë të të cilit i krijohet tërësisht bindja autoritetit për plotësimin e këtij kriteri. Në sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se autoriteti kontraktor duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë, duke vendosur kërkesa në lidhje me disponimin e mjeteve dokumentacionin e kërkuar, sikurse specifikohet në legjislacionin në fuqi.

Për këtë qëllim, njësia e prokurimit pranë autoriteti kontraktor, e cila në mbështetje të nenit 57 (“Njësia e prokurimeve”), pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është struktura përgjegjëse për “...përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme”, duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë, duke arsyetuar dhe argumentuar ndryshimin, ashtu sikurse përcaktohet në nenin 61 (“Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”), pika 2, të të njëjtit vendim.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “autoriteti kontraktor, pasi i është pëgjigjur ankesës së bërë nga ana jonë për procedurën proces ankimi, ka hequr nga pezullimi procedurën, duke mospritur afatin 10 ditor, afat i cili lejon ankimuesin ti drejtohet Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, pasi bëri verifikimin në SPE, konstatoi se autoriteti kontraktor e ka pezulluar procedurën e prokurimit dhe data e hapjes së ofertave është parashikuar data 23.11.2017 si më poshtë:

Objekti i tenderit: Shërbimi i Pastrimit në Bashkinë Mat

Autoriteti Kontraktues: Bashkia Mat | Data e hapjes: 20-10-2017 Ora : 08:00 | Data e mbylljes: 23-11-2017 Ora : 12:00 | Numri i referencës: REF-30293-10-18-2017
Fondi limit: 73,385,319.00 Lekë | Me lote: Jo | Anulluar: Jo | Pezulluar: Po

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe nenit 23 të VKM nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Ruçi” sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-30293-10-18-2017 me objekt: “*Sherbimi i pastrimit ne Bashkine Mat*”, me fond limit 73.385.319 lekë pa TVSH, parashikuar per t’u zhvilluar ne daten 13.11.2017 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mat.
2. Autoriteti kontraktor të modifikojë dokumentat e tenderit në përputhje me konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Ruçi” sh.p.k .
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1647 Protokoli,
Datë 03.11.2017



KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Zv/Kryetar
Leonard Gremshi

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

Anëtar
Odise Moçka

Kryetar
Evis Shurdha